

JETA SHKENCORE**FJALËFORMIMI NË DRITËN E QASJEVE DHE TË PRIRJEVE
BASHKËKOHORE****Konferencë shkencore ndërkombëtare**

Në kuadrin e Ditëve të Albanologjisë, veprimtarive të përvitshme të Akademisë së Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë organizoi më 17 dhjetor 2021 Konferencën shkencore ndërkombëtare “Fjalëformimi në dritën e qasjeve dhe të prirjeve bashkëkohore”, në të cilën, nëpërmjet prurjeve të shumta, bashkësia e kërkuesve shkencorë, e studiuesve dhe e pedagogëve u bë pjesë e një debati shkencor mbi probleme të ndryshme që lidhen me fjalëformimin në gjuhën shqipe, duke krijuar një tablo më të qartë të karakteristikave formale, funksionale dhe tipologjike të sistemit të fjalëformimit në gjuhën shqipe, nisur nga baza të ndryshme teorike.

Në këtë Konferencë, përveç punonjësve të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, morën pjesë dhe studiues e pedagogë nga Universiteti i Tiranës, i Shkodrës dhe i Durrësit, si dhe nga Kosova.

Fjalën përshëndetëse e mbajti Drejtori i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, prof. dr. Artur Lama, për të vijuar më tej me seancën plenare, në të cilën kumtuan: Emil Lafa: *A ka prapashtesë -ues dhe -yeshëm?*; Leonard Dauti: *Mbi interpretimin teorik të mënyrës fjalëformuese dhe tipologjinë përkatëse në gjuhën shqipe*; Shefkije Islamaj: *Krijimtaria leksikore në romanet e Rexhep Qosjes*; Valter Memisha: *Fjalëformimi si proces pasurues i leksikut të shqipes në fjalorët gjuhë e huaj – shqipe*; Adelina Çerpja: *Çështje teorike të fjalëformimit: procese të ashtuquajtura periferike*; Tomorr Plangarica: *Mbi disa aspekte të fjalëformimit në gjuhën shqipe sipas pikëvështrimit të gjuhësisë analogjike*; Mimoza Priku: *Disa kahe të reja në fjalëformimin e shqipes*; Anila Omari: *Çështje të fjalëformimit në shqipen e vjetër*; Seit Mansaku: *Njëfjalësimi i togjeve të fjalëve – një prirje pasuruese dhe intelektualizuese në fjalëformimin e sotëm të shqipes (motivimi kuptimor sintaksor dhe motivimi formal morfologjik)*.

Më tej punimet e konferencës vijuan me dy seanca paralele, në të cilën u kumtuan: *Disa problematika në trajtimin e fjalëformimit nga Gramatika I (sugjerime për konceptime të reja)* nga Albana Deda; *Gjedhe fjalëformimi në tekstet e vjetra shqipe* nga Evalda Paci; *Sindajshtesat në kuadrin e mjeteve të fjalëformimit në gjuhën shqipe* nga Anila Çepani; *Çështje fjalëformimi në të folmen e Gjakovës* nga Naim Berisha; *Gjedhe fjalëformuese te neologjizmat e Poradecit* nga Natasha Poroçani; *Dukuri të formimit të termave të kompjuteristikës në tekstet shkollore* nga Abdurrahim Maxhuni; *Jetë e re – gjuhë*

e re. Neologjizmat si zgjidhje për qëndrimet “shkenciste” ndaj gjuhës nga Rafaela Marteta; Struktura leksikore dhe fjalëformuese në krijimtarinë letrare të Beqir Musliut nga Begzad Baliu – Faton Krasniqi; Vëzhgime fjalëformuese te Xhojsi (J. Joyce) në shqip nga Erjena Lamaj.

Edhe gjatë seancës së dytë u sollën kontribute me mjaft vlerë për fjalëformimin në gjuhën shqipe: Begzad Baliu: *Struktura fjalëformuese e leksikut në romanin e Rexhep Qosjes, “Bijtë e askujt” (I, II)*; Juliana Kume: *Rreth disa veçorive të frazeotermave në ligjërimin e zakonshëm*; Enkelejda Shkrelji: *Rigramatikëzimi si proces fjalëformues. Shestim mbi sintagmat “në ndërkohë” dhe “me patjetër”*; Shkëlqim Millaku: *Rreth kompozitave në disa tregime të Kadaresë*; Valbona Sinanaj: *“Ë”-ja mbështetëse në proceset fjalëformuese*; Sejdi Gashi: *Disa mënyra fjalëformuese në arealin gjuhësor të Istogut me rrethinë*; Manjola Zaçellari: *Emërtimet e shkurtuara në publicistikën e viteve të fundit*; Adelinë Selmani: *Tema fjalëformuese onomatopeike në sistemin foljor të shqipes*; Engjëllushë Karaj: *Ndajfoljet në “Fjalorin e gjuhës shqipe” të Aleksandër Xhuvanit – formimet me prejardhje*; Servete Derguti: *Formimet parashtesë–prapashtesore në “Fjalorthin e ri” të Nikollë Gazullit*.

Në të tria seancat kumtuesit sollën kontribute me vlerë për gjedhe të reja fjalëformuese, për mjetet konkrete të formimit të fjalëve, si dhe për ndryshimet semantike që kanë ndodhur në vite gjatë pasurimit të shqipes me fjalë të reja.

Krahas sugjerimit për hartimin e një vepre përgjithësuese edhe në këndvështrimin historik për gjedhet fjalëformuese, një vend të rëndësishëm në këtë konferencë zunë qasjet bashkëkohore teorike, nisur nga këndvështrime të ndryshme, të cilat lidhen me interpretime të reja teorike të mënyrave të fjalëformimit në raport me tipologjitë dhe konkretizimin e tyre në gjuhën shqipe, p.sh. proceset periferike fjalëformuese, sindajshtesimi, rigramatikëzimi, huazimi etj.

Disa prej studiuesve u ndalën në pasqyrimin që fjalorë të ndryshëm i kanë bërë pasurimit të shqipes nëpërmjet gjedheve të ndryshme fjalëformuese në fjalorë të ndryshëm të shqipes.

Gjithashtu një vend të veçantë zuri dhe trajtimi i formimit dhe i përshkrimit të termave të kompjuteristikës, të frazeotermave, i emërtimeve të shkurtuara, si dhe i rolit që ka zanorja mbështetëse ‘ë’ në fjalëformim.

Roli i fjalëformimit në pasurimin e gjuhës së shkrimtarëve të ndryshëm ishte objekt i disa kontributeve, ndërsa u sollën në këtë konferencë edhe analiza të dukurive tipike të fjalëformimit në të folme të ndryshme.

Qasjet e reja teorike që u paraqitën, mendimet e sugjerimet rreth tyre sigurojnë mundësi të reja interpretimi dhe zgjidhjeje për çështje ende të diskutueshme, qoftë në rrafsh teorik, qoftë në atë zbatues për gjuhën shqipe: për lidhjen e analizës fjalëformuese me nivele të tjera të analizave gjuhësore, për njësitë operuese dhe kufijtë mes tyre, për termat e përdorur, për ndryshimet strukturore dhe semantike që ndodhin gjatë fjalëformimit etj.

Adelina Çerpja